



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 863 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2022

VENDIM
Nr. 335, datë 01.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saf”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.07.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji, z. Ols Lafe në kuadër të projektit “*Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe Tiranë Nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri*” me aplikues Elfjori Zotaj dhe zhvillues Autoriteti Rrugor Shqipëtar;
2. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

